

VENDIM
Nr. 442, datë 4.7.2014

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES TË OBJEKTIT “SALLA VIP E AEROPORTIT “NËNË TEREZA”” DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 229, DATË 23.4.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E CEREMONIALIT ZYRTAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 të ligjit nr. 8743, datë 31.7.2000 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, dhe të neneve 12, pika 2 e 49, të ligjit nr. 9095, datë 3.7.2003, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, për “ALBCONTROL”, sh.a.-në, të objektit “Salla VIP e Aeroportit “Nënë Tereza”, pjesë e pasurisë numër 201/3, në zonën kadastrale nr. 3183, Rinas.

2. Salla VIP e Aeroportit “Nënë Tereza”, brenda destinacionit të saj, do të përdoret nga “ALBCONTROL”, sh.a.-ja, e cila do të ofrojë edhe shërbimet që ofrohen aktualisht nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, sipas rregullave të miratuara nga ministri i Punëve të Jashtme dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

3. Shërbimet e protokollit të shtetit në “Sallën VIP të Aeroportit “Nënë Tereza””, do të vijojnë të drejtohen nga Zyra e Protokollit të Shtetit, në varësi të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

4. “ALBCONTROL”, sh.a.-së, i ndalohet të ndryshojë destinacionin e objektit “Salla VIP e Aeroportit “Nënë Tereza””.

5. Nënndarja 2.5, e pikës 2, “Përdorimi i sallës VIP të Aeroportit”, të kapitullit V, “Vizita dhe takime”, të ceremonialit zyrtar në Republikën e Shqipërisë, bashkëlidhur vendimit nr. 229, datë 23.4.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shfuqizohet.

6. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe “ALBCONTROL”, sh.a.-ja, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama